



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Numri i lëndës: 2022:096772  
Datë: 28.05.2024  
Numri i dokumentit: 05744424

**Kom.Dh.Shk.II.nr.1019/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj – Sheremeti, kryetare e kolegjit, Dren Rugova dhe Franciska Zhitija – Ymeri, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike - konfliktin administrativ sipas propozuesit – 1) “N.T.SH G.B.-Construction” me NUI 810230095 dhe seli rrugën UÇK p.nr. në Gjakovë dhe 2) “Ylli i Pashtrikut” ShPK me NUI 810514324 dhe seli në rrugën Nëna Terezë nr. 382 Gjakovë, të cilit sipas prokurës i përfaqëson avokati Korab Bokshi me seli në rrugën Tirana nr. 40 në Gjakovë, kundër të paditurit Komuna e Gjakovës me seli në Gjakovë, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit – paditësit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për çështje administrative K.A.nr.1166/22, të datës 01.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e propozuesit – paditësit 1 “N.T.SH G.B.-Construction” në Gjakovë dhe 2 “Ylli i Pashtrikut” ShPK, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës –

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative K.A.nr. 1166/22, të datës 01.03.2024, VËRTETOHET.

### **A r s y e t i m i**

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative, me Aktvendimin e ankimuar ka vendosur: REFUZOHET si e pabazuar kërkesa e paditësit 1)“N.T.SH G.B.-Construction” me NUI 810230095 dhe seli rrugën UÇK p.nr. në Gjakovë dhe 2) “Ylli i Pashtrikut” ShPK, me NUI 810514324, për shtyerje e ekzekutimit të aktit administrativ pa numër protokollit të datës 13.04.2022 të paditurit Komuna e Gjakovës me të cilin ka refuzuar ankesën nr.-01-070/018364 të datës 01.04.2022, deri në vendim përfundimtar të gjykatës.

Kundër këtij Aktvendimi, ka ushtruar ankesë propozuesi, me pretendime për shkak të shkeljeve të rregullave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që të aprohet si e bazuar ankesa e paditëses dhe aktvendimin e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative ta anuloj.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar pala kundër propozuese,

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e ankimuar, e ka refuzuar kërkesën e paditësit/propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues, me arsyetimin se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit, përkatësisht nuk është

vërtetuar se cili është dëmi konkret dhe si është i matshëm ky dëm që i shkaktohet paditësit, dhe i cili dëm vështirë do të riparohej me ekzekutimin e vendimit kontestues.

Gjykata në shkallë të parë vlerësoi se për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 22 par. 2 të LKA-së, Lidhur me pajtueshmërinë e shtyrjes së ekzekutimit të vendimit administrativ me interesin publik, gjykata e vlerëson si të pabazuar pretendimin e Paditësit se atij do t'i pamundësohej realizimi i projektit të tij në rast se dikush tjetër e lidhur kontratën për shfrytëzimin afatgjatë të parcelës komunale, meqenëse nuk ka asnjë indikacion të bazuar në prova se Paditësi do të shpallej sigurt fitues i procedurës publike për marrjen në shfrytëzim të tokës komunale.

Paditësit nuk kanë ngritur asnjë pretendim se shtyrja e ekzekutimit të vendimit administrativ të goditur nuk do të ishte në kundërshtim me interesin publik, e aq më pak kanë paraqitur prova për ta provuar plotësimin e kushtit të dytë nga neni 22 para. 2 të LKA-së.

Gjithashtu shkalla e parë vlerësoj paditësi nuk e ka provuar se me ekzekutimin e aktit administrativ të goditur atyre do t'ju shkaktohej dëm, i cili vështirë do të riparohej, si kusht i parë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit. Në këtë drejti, Paditësit nuk kanë paraqitur asnjë provë nga e cila së pari do të rezultonte se atyre në rast të ekzekutimit të aktit administrativ të goditur do t'iu shkaktohej dëm në vlerën prej 500,000€, siç kanë pretenduar ata, si dhe ai dëm është vështirë i riparueshëm. Për këtë gjykatë, mundësia për shkaktimin e dëmit nuk paraqet fakt notor.

Andaj, duke qenë se për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 22 par. 2 të LKA-së, ndërsa paditësi nuk ka arritur që të argumentojnë plotësimin e tyre ashtu siç parashihet me dispozitën ligjore të lartcekur, gjykata vendosi që të refuzojë kërkesën e tij për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit. Ndërsa lidhur me pretendimet e tjera të paraqitura në padi, gjykata do të vendosë në mënyrë meritorë pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë, por që këto pretendime nuk ishin me ndikim me rastin e vlerësimit të bazueshmërisë së kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas

vlerësimi të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 dhe 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do të sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do të sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Edhe kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë njëjtë si gjykata e shkallës së parë vlerëson se shtyrja e ekzekutimit të vendimit paditësit nuk do t'i sillte dëm i cili vështirë do të riparohej si dhe nuk është argumentuar se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, kushte këto të përcaktuara në nenin 22 par.2 të LKA-së.

Pretendimet ankimore të palës paditëse/propozuese, të cekura si më lartë, dhe të shtjelluara si në arsyetim të ankesës për shkeljet e pretenduara nga gjykata e shkallës së parë, kolegji i vlerëson se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme për vendosjen e kësaj çështje në mënyrë tjetër, sepse nuk dëshmohet se aktvendimi i goditur është i nxjerrë me shkelje të dispozitave të procedurës siç pretendon e paditura në ankesë. Ngase edhe vlerësimi i kolegjit është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 dhe 6 të LKA-së.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji gjen se Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës të Komuna e Gjakovës me seli në Gjakovë nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit, me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar.

Meqë në këtë rast paditësi në ankesën e ushtruar nuk ka bërë të besueshme me asnjë provë pretendimet e saj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

**Dhomat e Shkallës së Dytë**

**Kom.Dh.Shk.II.nr. 1019/24, me datë 28.05.2024**

**Kryetarja e kolegjit-Gjyqtarja**

**Saranda Bogaj Sheremeti, d.v**